

## **KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË SUBJEKTET**

### **TË CILËT JANË TË INTERESUAR PËR BASHKËPUNIM ME AZHBR PËR TË QENË PJESË AKTIVE NË REALIZIMIN E INVESTIMEVE TË PARASHIKUARA NË PROGRAMIN IPARD**

- Të regjistrohet në Sistemin elektronik të Bazës së të dhënave për Çmimet e Referencës (PRDB).
- Të ketë nënshkruar Marrëveshjen (tip) të bashkëpunimit me AZHBR.
- Të jetë regjistruar në QKB, për subjektet që zhvillojnë aktivitetin brenda territorit të Shqipërisë, ose regjistruar në organet kompetente sipas legjislacionit të vendit ku zhvillojnë aktivitetin jashtë territorit të Shqipërisë.
- Të dërgoj çmimet/ofertat me e-mail në adresën [cmime.reference@azhbr.gov.al](mailto:cmime.reference@azhbr.gov.al) brenda afatit të përcaktuar e të njoftuar nga AZHBR.
- Të paraqesë pranë AZHBR listën e çmimeve/ofertat për zëra/asete vetëm për investime fusha e të cilëve janë të parashikuara në Ekstraktin e QKB në seksionin “Objekti i aktivitetit”/”Regjistri Firmës”.
- Çmimet të jenë pa TVSH dhe të kenë vlefshmëri jo më pak se 1 (një) vit nga dërgimi në AZHBR.
- Listat e çmimeve/ofertat, dokumentacioni dhe informacioni që dërgohen në AZHBR të përmbajnë Logon e subjektit (nëse disponon), të jenë të firmosur nga titullari ose personi i autorizuar dhe të vulosur me vulë të njomë ose vulë elektronike si dhe të jenë në formatin pdf.
- Të paraqesë autorizimin nga subjekti prodhues ose distributori për të drejtën e shitjes së produktit në rastin kur subjekti është importues/eksportues.